

**VIKTIMIZIMI, PËRKRAHJA SOCIALE DHE REZILIENCA TEK ADOLESHENTËT E  
SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA NË KOMUNËN E GJILANIT**

**MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM**

**Nga:**

**Donjeta Lenjani**

**Mentore e Temës: Prof. Dr. Kaltrina Kelmendi**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË**

**Korrik, 2022**

Ky studim ka për qëllim të shohë viktimizimin ndaj bullizmit, reziliencën, si dhe përkrahjen sociale dhe familjare që adoleshentët e shkollave të mesme të larta në komunën e Gjilanit e marrin pas ballafaqimit me situata jo të mira apo bullizuese. Me anë të realizimit të këtij studimi synojmë të identifikojmë se sa është prezente viktimizimi i adoleshentëve ndaj bullizmit në shkolla të mesme, se sa ata janë rezilientë ndaj atyre përvojave që kanë kaluar përgjatë jetës së tyre, si dhe të bëhet identifikimi se nga kush ata marrin përkrahje kur ata ndihen të bullizuar apo janë viktima të bullizmit, si nga ana familjare, po ashtu edhe nga ana sociale, si dhe ndërlidhjen e tyre. Njëashtu, do të shohim dhe vlerësimet aktuale të jetës së tyre pas kalimit të situatave vështirësuese të viktimizimit ndaj bullizmit. Instrument i përdorur është pyetësori i ndarë në katër seksione si: pyetësori i viktimizimit, reziliencës, përkrahjes sociale dhe përkrahjes familjare. Ky studim është korrelacional i cili është realizuar me N=200 pjesëmarrës, prej tyre (N= 101 ose 50.5%) pjesëmarrës ishin vajza, ndërsa (N= 99 ose 49.5%) pjesëmarrës ishin djem. Në këtë studim prej tyre kanë qenë (N= 115 ose 57.5%) pjesëmarrës me vendbanim urban, ndërsa (N= 85 ose 42.5%) pjesëmarrës me vendbanim rural. Gjithashtu me anë të këtij studimi janë dhënë rekomandime në raport me ndryshimin e qëndrimeve bullizuese për adoleshentët ndaj njëri-tjetrit, si dhe për krijimin e një ambienti apo marrëdhënie sa më pozitive ndaj njëri-tjetrit.

Kur flasim mbi këtë temë, si një problem i përhapur në sistemet arsimore në mbarë botën, bullizmi mund të përkufizohet si një formë agresioni e drejtuar kundrejt një individi nga një ose më shumë individë (Olweus, 2013). Zakonisht ndodhë ndërmjet bullizuesve, nxënësve që ushtrojnë sjellje bullizuese ndaj nxënësve të tjerë dhe viktimave, nxënësve që janë objektiva të bullizmit sistematik më shumë se një herë (Solberg & Olweus, 2003). Për shumë vite, bullizmit i mungonte një përkufizim standard që mund të përdorej nga studiuesit. Kjo e bëri të vështirë përcaktimin se çfarë sjellje përbënte një akt bullizimi në krahasim me aktet e tjera të agresionit,

si sulmi seksual ose dhuna në familje. Prandaj, studiuesit u përpoqën të krijojnë një përkufizim uniform për përdorim në të gjithë literaturën e bullizmit. Olweus (1978) ishte autori i parë që përcaktoi dhe hulumtoi bullizmin midis adoleshentëve, ku sipas Olweus (1978; 1993) një person bullizohet nëse ai ose ajo ekspozohet në mënyrë të përsëritur dhe me kalimin e kohës ndaj veprimeve negative nga ana e një ose më shumë personave të tjerë. Këto veprime negative mund të jenë verbale (kërcënuese, degraduese, ngacmuese) dhe fizike (goditja, shkelmimi, shuplaka, shtyrja, vandalizimi i pronës, gjestet e vrazhda dhe mimikat e fytyrës). Në mënyrë të ngjashme, Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve dha një përkufizim uniform për bullizmin, i cili është shumë afër përkufizimit origjinal të dhënë nga Olweus (1993) i cili thotë se bullizmi në çdo sjellje agresive të padëshiruar që përfshijnë një çekuilibër të vrojtuar ose të perceptuar të fuqisë ose që përsëritet disa herë ose ka të ngjarë të përsëritet, kjo sjellje mund të shkaktojë dëm ose shqetësim tek personi që bullizohet apo viktimë, duke përfshirë dëmtim fizik, psikologjik, social dhe edukativ.

Gjithashtu kur flasim mbi viktimizimin, nuk ka konsensus të qartë kur bëhet fjalë për konceptualizimin e viktimizimit edhe pse disa e konsiderojnë viktimizimin sinonim me termin bullizëm, të tjerë i dallojnë termat dhe e shohin viktimizimin si një koncept më të gjerë që përfshin bullizmin (Olweus, 1993). Sipas Söderberg dhe Björkqvist (2019), koncepti i viktimizimit të bashkëmoshatarëve, i përcaktuar si një situatë në të cilën dikush është objektiv i sjelljeve të shpeshta agresive fizike apo verbale nga bashkëmoshatarët (Kochenderfer & Ladd, 1996) nuk supozon në mënyrë eksplicite një mosbalancim të fuqisë ndërmjet kryesit (autorit) dhe viktimës. Megjithatë, viktimat e bullizuara raportojnë se kanë përjetuar depresion, izolim, vetëbesim të ulët, shpresë, frikë, pasiguri dhe përfshirje në sjellje të dhunshme ose vetë-shkatërruese (Espelage & Swearer, 2003; Nansel et al., 2001; Olweus, 1993). Për më tepër,

viktimat e bullizmit performojnë më pak nga ana akademike (Thijs & Verkuyten, 2008) si pasojë e përvojave të tyre të viktimizimit. Adoleshenca shënon gjithashtu një kohë kur individët mund të jenë më të ndjeshëm ndaj efekteve të viktimizimit për shkak të ndryshimeve në marrëdhëniet shoqërore me bashkëmoshatarët dhe të rriturit, emocionet e rritura dhe ndryshimet biologjike (Pellegrini et al., 1999).

Andaj, përgjatë përvojave të adoleshentëve ne e dimë se adoleshenca është një periudhë mjaftë kritike dhe e ndjeshme, pasi që gjatë jetës së tyre ata përballen me situata të ndryshme dhe të vështira si në rrethin social, ashtu edhe në atë familjarë. Duke parë sfidat e adoleshentëve, atëherë shohim se viktimizimi është një ndër sfidat më të mëdha me të cilën përballen adoleshentët, prandaj përmes këtij studimi, kemi arritur që të shohim viktimizimin ndaj bullizmit, reziliencën e tyre si dhe përkrahjen sociale dhe familjare që adoleshentët e shkollave të mesme të larta e marrin pas ballafaqimit me situata jo të mira apo bullizuese. Nga gjetjet në studimin tonë është parë se nga analiza e Chi-Square,  $X^2(1, N=200) = 8,962, p=.003$ . Kjo na tregon se kjo analizë është e rëndësishme statistikisht, pra, ndërrimet gjinisë dhe nëse adoleshentët janë frikësuar ose janë ndierë vërtetë keq sepse të tjerët i'u kanë ngjitur emra të pahijshëm, i'u kanë thënë gjëra të pakëndshme, ose i'u kanë thënë të mos sillen andej pari, pra, si meshkujt ashtu edhe femrat janë viktimat e bullizmit në shkollat e mesme të komunës së Gjilanit, ku në tabelën e frekuencave totali i pohimeve të 200 adoleshentëve është parë se 140 ose 70% e adoleshentëve kanë pohuar se kanë qenë viktimat e bullizmit.

Gjithashtu në studimin tonë janë parë edhe dallimet gjinore, ku për sa i përket viktimizimit të bullizmit nga pohimet e adoleshentëve të shkollave të mesme të larta në komunën e Gjilanit, mesatarja e vajzave është 1.41, pra, më e lartë se mesatarja e djemve 1.20., që do të thotë se vajzat janë viktimat e bullizmit më shumë në krahasim me djemtë. Gjithashtu është parë

se adoleshentët marrin hapa për t'u kujdesur më mirë për vetën dhe familjen për të ardhmen e tyre, që do të thotë se ata janë rezilientë kur ata përballen me situata bullizuese; megjithatë në studimin tonë është bërë edhe krahasimi i reziliencës në funksion të gjinisë, ku nga rezultatet e arritura është parë se egziston një dallim i rëndësishëm statistikor, ku për sa i përket reziliencës pas ballafaqimit me situata bullizuese, nga pohimet e adoleshentëve të shkollave të mesme të larta në komunën e Gjilanit, mesatarja e vajzave është 3.06, pra, më e lartë se mesatarja e djemve 2.45., që do të thotë se vajzat janë reziliente më shumë pas përjetimit të situatave viktimizuese ndaj bullizmit në raport me djemtë.

Në këtë studim duke përdorur analizën e korrelacionit, shohim se kemi korrelacion pozitiv dhe signifikan ndërmjet viktimizimit të adoleshentëve të shkollave të mesme të komunës së Gjilanit dhe mbështetjes nga ana familjare e tyre, ku  $r=.338^{**}$ ,  $p=.000$ , që do të thotë se kur adoleshentët e shkollave të mesme të komunës së Gjilanit, janë viktimat të bullizmit, atëherë ata gjithashtu kanë edhe përkrahjen nga ana familjare e tyre. Gjithashtu është parë se kemi korrelacion pozitiv dhe signifikan që reziliencia tek adoleshentët arrihet edhe me ndihmën e mbështetjes sociale, ku  $r=.455^{**}$ ,  $p=.000$ . Po ashtu është parë se kemi korrelacion pozitiv dhe signifikan që reziliencia tek adoleshentët arrihet edhe me mbështetjen familjare, ku  $r=.557^{**}$ ,  $p=.000$ .

Andaj, duke u bazuar në temën tonë mbi viktimizimin, janë të rëndësishme edhe disa programe ndërhyrjeje të kohëve të fundit (p.sh., Salmivalli, Kärnä dhe Poskiparta, in Press) fokusohen në ndryshimin e dinamikës së grupit në mënyrë që të motivojnë kalimtarët e rastit apo personat prezentë që të marrin anën e bashkëmoshatarëve apo adoleshentëve të viktimizuar dhe të bëhen mbrojtësit e tyre. Megjithatë statusi ndërmjet bashkëmoshatarëve duket të jetë një element kyç që duhet marrë parasysh në ndërhyrjet, efektiviteti i të cilave mund të rritet duke u

fokusuar më shumë në përmirësimin e barazisë së marrëdhënieve në klasë apo në shkollën, rrethin në të cilën gjenden. Për më tepër, programet klasike të ndërhyrjes (p.sh., Olweus, 1993) përfshinë veprime që synojnë rritjen e aftësive empatike, që besohet se u mungojnë ngacmuesve. Këto të dhëna sugjerojnë se aftësitë empatike kanë më shumë gjasa të nxisin mbrojtjen sesa të pengojnë ngacmimin. Prandaj, veprime të tilla duhet të synojnë mbi të gjitha kalimtarët e rastit apo personat prezentë, duke inkurajuar sjelljen e tyre aktive pozitive.

Gjithashtu janë të rëndësishme edhe rolet e mësimit dhe të profesionistëve të tjerë të arsimit, pasi që janë thelbësore për t'i dhënë fund tendencës së përshkruar në rritje të bullizmit, pasi që në këtë drejtim, nevojitet një trajnim specifik për identifikimin e të gjitha llojeve të bullizmit, duke përfshirë agresionet fizike më të dukshme, por edhe llojet verbale dhe relacionale të bullizmit (Inmaculada et al., 2017).